

PASURIA JONË



QEVERISJA E POPULLIT, DEMOKRACIA

ELIZA (13), SIHANA (14), ELODI (13), ART (13), ARDIT (14), MIC (14), LEON (13)



Çka mendoni ju të dashur lexues, se demokracia është vetëm e drejtë e fjalës dhe e votës dhe asgjë më shumë? Nëse rastësisht pajtoheni me këtë, grupi ynë ju tregon se demokracia është më shumë se kaq. Se çka dhe si është demokracia për ne, lexoni artikullin në vijim

Të jetosh në një vend ku ka demokraci, do të thotë të jesh i lumtur dhe të gjesh paqe në jetë. Të kesh demokraci do të thotë të bashkëpunosh, e në raste të nevojshme të tregohesh edhe tolerant. Por jo vetëm kaq. Demokracia është shumë më e gjerë se këto që i cekëm me lart. Mirëpo, pa këto është e pamundur të paramendohet demokracia, sepse që të gjitha janë në lidhje të ngushtë me njëra-tjetrën dhe bashkë e formojnë zingjirin demokratik. Ne e dijmë që edhe pa një hallkë zingjirore në këtë rast për shembull pa tolerancën, demokracia do të funksionojë, por ja që nuk do të jetë e plotë. Ne nuk mund të themi që vendi ynë nuk do të ekzistonte nëse qytetarët nuk do të tregoheshin shumë tolerant me njëri-tjetrin e nuk do të tregoheshin solidarë. Çka jemi të sigurt është se falë këtyre elementeve, rritet ende më shumë vlera dhe rëndësia e demokracisë. Shumë e lehtë është të flasësh, por kjo nuk do të thotë që është e vështirë të veprësh. Nuk është aspak e vështirë që ta respektosh mendimin e tjetrit, e as nuk është e vështirë të tregohesh solidar në rrethana të ndryshme. Për ne, nuk është aspak e vështirë që të gjithë shokët e shoqet tona t'i trajtojmë në mënyrë të barabartë. Ne jemi shumë me fat, ngaqë jetojmë në një vend ku demokracia vepron. Në diktaturë është krejtësisht e kundërta, sepse aty udhëheq


e vendos vetëm njëri. Për të demonstruar më mirë dallimin në mes të diktaturës dhe demokracisë, ne e ndamë grupin në dy sisteme: në atë demokratik dhe diktatorial. Kishte bindshëm më shumë të mira në sistemin demokratik sesa në atë diktatorial. Si p.sh. në demokraci kishte dhe ka pluralizëm politik, ka zgjedhje të lira, ka shprehje të mendimit të lirë, etj. Ndërsa, në diktaturë të gjitha këto lirisht mund të themi se bien poshtë. Aty nuk ka zgjedhje të lira por vetëm të imponuara, nuk ka pluralizëm politik, është vetëm diktatori ai që sundon, etj. Prandaj, ne e gjejmë veten tek demokracia. Mesazhi ynë për gjithë këtë temë është se ne duhet t'i trajtojmë të gjithë njerëzit në mënyrë të barabartë të lirë. Pra, të jenë vetëvetja.



Jemi demokratë dhe trajtohem si të tillë

KUVENDI, RUBIKONI I JETËS SONË

NIKI (14), ENDRI (14), LYRA (13), EMA (13), INVA (13), ENEIDA (13), DRIN (14), VALDI (13)



Kuvendi është institucion i cili përpiqet të na zgjidh problemet tona si qytetarë!

Kur flasim për rubikonin, e dijme se është me shumë ngjyra dhe personi që duhet ta rregullojë atë, duhet ta gjejë zgjidhjen më të përshtatshme. Por, si mund ta paraqesim Kuvendin përmes rubikonit? Këtë do ta mësoni në këtë artikull

Të ofrosh zgjidhje për të gjithë dhe të gjithë t'i kenë gjërat e nevojshme për jetë, do të thotë të ofrosh mirëqenie. E pikërisht institucioni që kujdeset për këtë

se pa bashkëpunimin e kubeve me ngjyra të ndryshme nuk marrim figurën e dëshiruar.

E kështu edhe Kuvendi yonë për të arritur një vendim-marrje sa më të mirë, duhet t'i marrë parasysh nevojat dhe interesat e të gjithëve. Kuvendi ndër të tjerash, luan rol legjislativ gjë që do të thotë se propozon dhe miraton ligjet. E nëse do të ishte jeta jonë pa ligje, do të ishte një kaos i vërtetë.

Andaj, dëshirojmë ta potencojmë se Kuvendi luan një rol mjaft të rëndësishëm në jetën tonë të përditshme. Artikullin duam ta përfundojmë me thënien: „Si është populli ashtu është edhe qeverisja“. Që nënkupton se një popull i mirë di të bëjë zgjedhjen adekuate të personave përfaqësues të shtetit. Prandaj, vetëdijësimi i popullit për konceptet demokratike është më se i nevojshëm. Le të funksionojmë edhe ne ashtu siç funksionon rubikoni. Të ndryshëm, por të barabartë dhe me vlerë të madhe.



Gjithmonë duke ndjekur rrugën e duhur

është Kuvendi, i cili mundohet që gjithmonë të ofrojë zgjedhje më të mirë për popullin e tij. Ashtu si në rubikon, për të arritur qëllimin e duhur duhet t'i bashkojmë kubet e vogla për të formuar tërë faqen e kubit me një ngjyrë, ashtu edhe Kuvendi duhet të bëjë përpjekjet për të plotësuar të gjitha dëshirat dhe qëllimet e popullit në mënyrë të barabartë. Siç e keni vërejtur edhe në rubikon kubet kanë ngjyra të ndryshme, por madhësia dhe vlera e tyre është e njëjtë. Kjo dëshmon



Ne jemi e ardhmja e vendit

TË JAPIM MË TË MIRËN PËR VENDIN TONË

GOJART (14), GRETA (14), RREZON (13), JON (14), MERIOLA (13), AMBROZI (13), ERION (13)



Qytetari aktiv, ndihmon në komunitet

Ne njerëzit, jemi qeniet e gjalla më perfekte. Kjo na bën neve të jemi shumë kërkues ndaj vetes sonë, por edhe ndaj të tjerëve.

Ne jetojmë në një shtet demokratik, e kjo do të thotë se ne si qytetarë kemi shumë të drejta. Duke filluar nga e drejta e punës, e arsimit, e argëtimit, e krijimit të familjes, e deri tek e drejta e jetës. Me këto detyra, në demokraci vijne edhe përgjegjësitë. Këto përgjegjësi janë: përgjegjësia e pjesëmarrjes në procesin zgjedhor, pagimi i taksave, mbajtja e pastërtisë së ambientit, etj.

Përgjegjësitë nuk janë të obligueshme, por nëse i bëjmë ato, ai veprim ndikon tek ne dhe tek shoqëria që

na rrethon. Është fjalë për përgjegjësinë e të votuarit. Nëse ne votojmë, kontribuojmë në shoqërinë tonë, e kjo na bën neve qytetarë aktiv. Ne jemi qytetarë aktiv, nëse kontribuojmë në shoqërinë tonë. Ne si nxënës të shkollës së mesme të ulët „Mazlum Këpuska“, mundohemi që të jemi qytetarë aktiv, duke mbjellur fidane, lule e pemë të ndryshme çdo vit në oborrin e shkollës sonë. Me këtë, ne kontribuojmë për një ajër të pastërt e bukuri të shkollës sonë. Së bashku japim pak por fitojmë shumë më tepër. Me këtë artikull, ne duam t'iu frymëzojmë juve lexues të dashur dhe të ju inkurajojmë që të bëni veprime të tilla. Në këtë mënyrë ju fitoni kulturë të punës, bëheni më të përgatitur për jetë. Ju faleminderit.



Ne jemi grupi i vizatimeve



Ta mbajmë pastër ambientin

ZGJEDHJET JANË E DREJTA JONË


EDIS (13), ALB (13), AZRA (13), BESNIK (13), ALBA (13), LEA (13), REDON (13)

Çdo njeri i ka kërkesat e veta. Secili prej tyre, bën zgjedhje për të ardhmen e vet dhe secili i ka preferencat e veta. Disa prej tyre kanë dëshirë të lexojnë, disa të këndojnë, disa të pikturojnë, e disa të tjerë të merren me sport. Prandaj, jemi ne ata që vendosim se çka do të zgjedhim për veten tonë.

Mua Gojartit, për dallim prej motrave dhe vëllezërve të mi, mua më pëlqen më së shumti të lexoj. Leximi më bën të ndihem vetëvetja, prandaj edhe e bëj këtë aktivitet me shumë dëshirë.

Këto zgjedhje të cilat i cekëm më lart, ndikojnë më shumë në jetën tonë dhe jo tek të tjerët.


Ka zgjedhje të cilat ndikojnë edhe në rrethin ku jetojmë. Këto janë zgjedhjet lokale. Në këto zgjedhje, ne qytetarët zgjedhim se kush do të udhëheqë me komunën tonë. Pra, duke votuar për kryetarin/ren e komunës. Por kemi edhe zgjedhje të tjera të cilat ndikojnë në një masë më e gjerë. Është fjala për zgjedhjet qendrore. Në këto zgjedhje, ne i votojmë ata të cilët ne mendojmë se do t'i përmbushin kërkesat tona si qytetarë të Kosovës. Kjo na bën të ndihemi më të sigurt në vendin tonë. Në zgjedhjet lokale e ato qendrore, mund të marrim pjesë që nga moshën 18 vjeçare. Dil voto, sepse edhe ti je pjesë e këtij shteti.



Të punojmë për një botë më të mirë



Duke votuar, bëhesh qytetar aktiv



Kuvendi, institucioni ku punojnë përfaqësuesit tanë



Shkrimtarët e artikullit



IMPRESUM



Ky publikim është produkt i punës së pjesëmarrësve të projektit „Demos-ti“ i cili realizohet nga



REPUBLIKA E KOSOVËS / KUVENDI
REPUBLIKA KOSOVA / SKUPŠTINA
REPUBLIC OF KOSOVO / ASSEMBLY

i implementuar nga



Projekti është mundësuar dhe përkrahur nga



ERSTE Stiftung

Redaktohet nga
Kuvendi i Kosovës

Qëllimi i publikimit
Edukimi qytetar nëpërmes metodave edukative joformale

shtypur nga
TOKA

Na kontaktoni për të marrë pjesë: Pjesëmarrësit:
Tel: +381 38 704 560 SHFMU „Mazlum Këpuska“
E-mail: info@demos-ti.org Klasa: VIII-4
Website: www.demos-ti.org Vendi: Gjakovë